



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.460/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenkovic – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Guri Group & Guri ” SH.P.K - Istog , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Lot 1, OE “Ademaj Arch-Ing SH.P.K & Axis G.C.ë SH.P.K ”- Prishtinë dhe Lot 2 OE “ Te Aleni ” SH.P.K- Istog , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Betonimi i kanalit vërshtues të Rudeshit në Vrellë – Lot 1 ,dhe Betonimi i kanalit të ujitjes Vrellë-Lubozhdë –Lot 2” me nr. të prok: 633- 20 -1415- 5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Istog” (KKI), më datën: 05.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Guri Group & Guri ” SH.P.K – Istog, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Lot 1, OE “Ademaj Arch-Ing SH.P.K & Axis G.C.ë SH.P.K ”- Prishtinë dhe Lot 2 OE “ Te Aleni ” SH.P.K- Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Betonimi i kanalit vërshtues të Rudeshit në Vrellë – Lot 1 dhe Betonimi i kanalit të ujitjes Vrellë-Lubozhdë –Lot 2” me nr. të prok: 633- 20 -1415- 5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Istog” (KI).

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit me titull: “Betonimi i kanalit vërshtues të Rudeshit në Vrellë – Lot 1 dhe Betonimi i kanalit të ujitjes Vrellë-Lubozhdë –Lot 2” me nr. të prok: 633-20-1415-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Istog” (KI), dhe lënda të kthehet në **rivlerësim për Lot 1 & Lot 2.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha

veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Guri Group & Guri ” SH.P.K – Istog , aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Guri Group & Guri ” SH.P.K – Istog , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.07.2020 me nr. 460/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Lot 1, OE “Ademaj Arch-Ing SH.P.K & Axis G.C.ë SH.P.K ”- Prishtinë ,dhe Lot 2 OE “ Te Aleni ” SH.P.K- Istog , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Betonimi i kanalit vërshues të Rudeshit në Vrellë – Lot 1 ,dhe Betonimi i kanalit të ujitjes Vrellë-Lubozhdë –Lot 2” me nr. të prok: 633- 20 -1415-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Komuna Istog” (KI), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7 ,10 ,59, 60, të LPP-së , si dhe F03-shin.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 16.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 22.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Guri Group & Guri ” SH.P.K – Istog.

Përgjigje në Pretendimin nr.1, Eksperti shqyrtues konstaton se AK-së e eliminon OE ankues “GURI

GROUP & GURI” SHPK, me arsyetimin: “Ju keni ofruar një listë të mjeteve, ku të gjitha librezat e qarkullimit janë të skaduar jo valide, ndërsa “Guri SHPK”, ka ofruar dy marrëveshje për makinerinë të cilat marrëveshje kanë datë nënshkrimi me 08.04.2020, e të cilat marrëveshje nuk janë për aktivitetin në fjalë dhe nuk dihet se për çfarë afati janë bërë”.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: “Kërkesa 5 - Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshëm për realizimin e projektit min -1 Ekskavator me rrota, min. 12 ton. -1 Kamion me kapacitet min 10m3 kiper”, ndërsa te **Dëshmia dokumentare është kërkuar:** “Dëshmia – 5 Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar origjinal-e nënshkruar dhe vulosur nga O.E.. Pajisjet dhe mjetet në dispozicion duhet të dëshmohen me libeze të qarkullimit (valide), dud doganor apo faturë për blerje ose kontrate mbi qiramarrje për aktivitetin në fjalë”

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues “GURI GROUP & GURI” SHPK, në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e makinerisë me 35 pajisje, ku 33 janë në pronësi dhe 2 tjerat me nr. rendor 34 dhe 35, janë të huazuara. Si dëshmi për këto pajisje ka ofruar libeza dhe duda Doganor, varësisht prej pajisjes. Ndërsa për pajisjet e huazuara ka ofruar dy marrëveshje të lidhura në mes të “GURI GROUP” SHPK dhe Granit Demukaj, si dhe “GURI GROUP” SHPK dhe Tahir Blakaj, me dt:08.04.2020, para njoftimit për kontratë. Duke pasur parasysh që në dosjen e tenderit janë ofruar pajisjet e kërkuara, si dhe marrëveshjet për huazim të pajisjeve të cilat janë para njoftimit të këtij aktiviteti të prokurimit, mendoj se është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit, AK-së, për ta pasur më të qartë, mund të kërkoj sqarime shtesë nga OE, konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Si dhe në vendimin në të cilin është thirrur OE ankues 476-478/18, tek pjesa e arsyetimit thuhet:

Paneli shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë që ka pasur në dispozicion, sqaron se në dosje të tenderit tek kërkesat mbi aftësitë teknike dhe profesionale janë kërkuar një numër i pajisjeve për të cilat si dëshmi janë kërkuar faturat e blerjes, DUD, librezë qarkullimi, kontratë mbi qiramarrje etj. por nuk janë kërkuar që librezat e automjeteve të kenë validitet qarkullimi, madje edhe të ishte si kërkesë e dosjes së tenderit një kërkesë e tillë nuk do të konsiderohej e arsyeshme që të përdorej si argument për eliminim sepse e rëndësishme është që operatori ekonomik që ka ofertuar të dëshmoj se posedon kapacitetin e kërkuar i cili mund të jetë në pronësi apo mund të jetë i marrur me qira apo i huazuar, në rastin konkret OE ankues “Bajraktari” përveç automjeteve që ka në pronësi njëkohësisht ka marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve me OE “Integral” dhe lista e dorëzuar e pajisjeve nga OE “Bajraktari i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aftësitë teknike/profesionale. Po ashtu edhe OE i rekomanduar për kontratë posedon pajisje që ju ka skaduar afati i regjistrimit sepse regjistrimi për qarkullim është i nevojshëm me rastin e daljes së automjetit në rrugë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Operatori ekonomik ankues "GURI GROUP & GURI" SHPK, pretendon se me dt:23.06.2020, përmes postes elektronike (e-mailit), ka kërkuar qasje në dokumentet zyrtare, konkretisht në dosjet e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për Lot 1 dhe 2.

Siç shihet edhe në e-mailin më poshtë e anëtarit të konsorciumit "GURI" SHPK, drejtuar AK-së në adresën prokurimi istog@hotmail.com, e cila adresë është e shënuar edhe në Njoftimin për kontratë nga AK-së, qëndron ky pretendim, sepse askund në dokumentet e ngarkuara në e-prokurim, nuk kam mundur të has në ndonjë përgjigje në lidhje me kërkesën e bërë nga OE ankues.

Për më tepër shih e-mailin më poshtë:

From: GURISH.p.k[mailto:guri.vrelle@gmail.com] **Sent:** Tuesday, July 21, 2020 2:33 PM

To: OSHP

Subject: Kërkesë për qasje ne dokumentacionin zyrtar

Përshëndetje,

Gjeni e-mailin që ia kemi dërguar Zyrës së Prokurimit të Komunës së Istogut në lidhje me kërkesën për qasje në dokumentacion zyrtar. E-maili prokurimi_istog@hotmail.com është i njëjtë i dhënë në Njoftimin për Kontratë.

----- Forwarded message -----

From: **GURI Sh.p.k** <guri.vrelle@gmail.com>

Date: Tue, Jun 23, 2020 at 10:30 AM

Subject: Kërkesë për qasje ne dokumentacionin zyrtar

To: Prokurimi Komuna e Istogut <prokurimi_istog@hotmail.com>

Përshëndetje,

Kërkojmë qasje në tere ofertën e OE të rekomanduar për lot 1 **Ademaj Arch - Ing SH.P.K & Axis G.C.Ë. SH.P.K.** dhe të OE të rekomanduar për lot 2 **Te Aleni shpk** për aktivitetin e prokurimit:

LOTO1 - BETONIMI I KANALIT VERSHUES TE RUDESHIT NE VRELLE.

LOTO2 - BETONIMI I KANALIT TE UJITJES VRELLE-LUBOZHDE

Me numër të prokurimit:

633-20-1415-5-2-1

Ju faleminderit,

Stafi GURI sh.p.k

Gjithashtu në të njëjtën adresë elektronike të shënuar në njoftimin për kontratë i jam drejtuar AK-së përmes postës elektronike (e-mail). Në paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenin 10 të LPP-së, thuhet:

- Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.
- Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.
- Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Duke pasur parasysh që kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare, bërë nga OE ankues "GURI GROUP & GURI" SHPK, me dt:23.06.2020, nuk kam gjetur asnjë dëshmi se është ofruar qasje nga AK-së, mendoj se AK-së, ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 i LPP-së.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues/teknik:

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE

ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 22.07.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 24.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 23.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 05.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër vendimit të AK-së për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues sqaron se AK ka eliminuar OE ankues “GURI GROUP & GURI” SHPK, me arsyetimin: “Ju keni ofruar një listë të mjeteve, ku të gjitha librezat e qarkullimit janë të skaduar jo valide, ndërsa “Guri SHPK”, ka ofruar dy marrëveshje për makinerinë të cilat marrëveshje kanë datë nënshkrimi me 08.04.2020, e të cilat marrëveshje nuk janë për aktivitetin në fjalë dhe nuk dihet se për çfarë afati janë bërë”.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: “Kërkesa 5 - Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshëm për realizimin e projektit min-1 Ekskavator me rrota, min. 12 ton. -1 Kamion me kapacitet min 10m3 kiper”, ndërsa të Dëshmia dokumentare është kërkuar: “Dëshmia – 5 Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar origjinal-e nënshkruar dhe vulosur nga O.E.. Pajisjet dhe mjetet në dispozicion duhet të dëshmohen me libeze të qarkullimit (valide), dud doganor apo faturë për blerje ose kontrate mbi qiramarrje për aktivitetin në fjalë”

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues "GURI GROUP & GURI" SHPK, në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e makinerisë me 35 pajisje, ku 33 janë në pronësi dhe 2 tjerat me nr. rendor 34 dhe 35, janë të huazuara. Si dëshmi për këto pajisje ka ofruar librezat dhe dudadogonor, varësisht prej pajisjes. Ndërsa për pajisjet e huazuara ka ofruar dy marrëveshje të lidhura në mes të "GURI GROUP" SHPK dhe Granit Demukaj, si dhe "GURI GROUP" SHPK dhe Tahir Blakaj, me dt:08.04.2020, para njoftimit për kontratë.

Duke pasur parasysh që në dosjen e tenderit janë ofruar pajisjet e kërkuara, si dhe marrëveshjet për huazim të pajisjeve të cilat janë para njoftimit të këtij aktiviteti të prokurimit, paneli shqyrtues vlerëson se është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit, mirëpo AK ka qenë dashur që të kërkojë sqarime shtesë nga OE konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron që operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon kapacitetin e kërkuar i cili mund të jetë në pronësi, i marrë me qira apo huazuar, e që në rastin konkret nga shkresat e lëndës shihet se operatori ekonomik ka të huazuara disa nga pajisjet për cka edhe ka marrëveshje.

Operatori ekonomik ankues "GURI GROUP & GURI" SHPK, në ankesën e tij pretendon se me dt: 23.06.2020, përmes postes elektronike (e-mailit), ka kërkuar qasje në dokumentet zyrtare, konkretisht në dosjet e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës për Lot 1 dhe 2.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të dokumentacionit shihet se anëtar i konzorciumit "Guri" shpk i është drejtuar AK-së në adresën e prokurimit istog@hotmail.com, e cila adresë është e shënuar edhe në Njoftimin për kontratë të AK-së, ndërsa nuk ka marrë asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e parashtruar nga OE, andaj duke pasur parasysh këtë, paneli e vlerëson si të qëndrueshëm pretendimin e OE ankues.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 të LPP-së ku thuhet:

- Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është

anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.

- Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave.
- Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK nuk ka zhvilluar drejtë procedurën e prokurimit, më saktësisht ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Gjithashtu AK nuk ka zbatuar nenin 10 të LPP-së pasi që nuk i ka pofruar qasje operatorit ekonomik ankues.

Paneli shqyrtues sqaron se AK gjatë rivlerësimit duhet të ketë parasysh nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më të drejtë, efikase dhe më transparente të fonëve publike në mënyrë që ato të përdorën efektivisht në harmoni edhe me nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 /AK/ - "Komuna Istog" (KI) ,
- 1x1 / OE/ "Guri Group & Guri " SH.P.K – Istog
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

